



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 17 dhjetor 2021, në mbledhjen e II-rë (dytë) – mbledhje e jashtëzakonshme , të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunës, në ndërtesën e re të Komunës së Podujevës.

Mbledhjen e kryesoi z.Hilmi Hoxha, anëtar më i moshuar i zgjedhur dhe certifikuar nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve - KQZ.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës përveç z.Ekrem Hyseni dhe znj.Floretë Zejnullahu *(të cilët nuk kanë pranuar mandatin e anëtarit/es së Kuvendit të Komunës së Podujevës si dhe sipas Komisionit Komunal të Zgjedhjeve të njëjtit kanë dhënë dorëheqje nga cilësia e anëtarit/es së Kuvendit të Komunës së Podujevës)*, si dhe z.Gazmend Islami, që mungua.

Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave lokale dhe më gjerë, përfaqësues të KFOR, disa zyrtar komunal dhe një numër i qytetarëve.

Rend dite

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, e hapi mbledhjen duke i përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera, theksoi, të nderuar këshilltarë dhe këshilltare të Kuvendit, zotëri Kryetar i Komunës, zonja dhe zotërinj, e hapi mbledhjen e dytë të kësaj legjislature të Kuvendit të Komunës e cila është thirr si mbledhje e jashtëzakonshme për shkak të rëndësisë që ka konsolidimi i Kuvendit me zgjedhjen e Kryesuesit dhe një prej trupave të Kuvendit që është Komiteti për Politikë dhe Financa, në mënyrë që funksionimi i Kuvendit të vazhdoj normalisht me trajtimin e çështjeve dhe vendimeve për interes të përgjithshëm. Fillimisht në bazë të nënshkrimeve në listën përkatëse, konstatoj se 32 anëtarë janë prezent ndërsa mungojnë 3 anëtar, andaj kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me punë.

Thirrja e kësaj mbledhje u është dërguar me kohë dhe ashtu siç jeni në dijeni në bazë të dispozitave ligjore, rendi i ditës në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit nuk mund të plotësohet apo ndryshohet, andaj ju lutem a pajtoheni që të vazhdojmë me punë në bazë të rendit të ditës sipas materialit dhe thirrjes së mbledhjes, apo eventualisht mund të jetë ndokush kundër apo që abstenojnë, andaj ju lutem të deklamohemi me votim.

Pas votimit, Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se NJËZËRI u miratua rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës

➤ *Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit*

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, në bazë të nenit 2.3 të Udhëzimit Administrativ nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, parashihet që të ngritet një komision për mbarëvajtjen e procesit të votimit i cili parashihet të përbëhet 3 deri në 5 anëtarë të Kuvendit, i cili është përgjegjës që të numëroj votat dhe t'i komunikoj rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të komunës, dhe çështje tjera procedurale, andaj urdhëroni nëse ndokush ka ndonjë propozim rreth formimit të këtij komisioni, apo të shkojmë sipas renditjes së subjekteve të Kuvendit, qoftë me 3 apo 5 anëtar. Nëse nuk ka propozime për përbërjen e këtij komisioni, atëherë unë propozoj që ky komision të përbëhet prej 3 anëtarëve dhe atë nga subjektet politike LDK, LVV, PDK sipas përqindjes së përfaqësimit në Kuvend. Pra meqë që nuk ka propozime unë propozoj që Komisioni të përbëhet prej 3 anëtarëve.

Pas votimit, Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se me 13 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, dhe 17 vota të përmbajtura, miratohet propozimi që komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit të përbëhet prej 3 anëtarëve, dhe atë prej subjekteve me numrin më të madh të përfaqësimit në Kuvend që janë LDK, LVV dhe PDK.

Kryesues i mbledhjes, vazhdoi, tani ftoj përfaqësuesit e subjekteve të LDK-së, LVV-së dhe PDK-së, që sipas radhës t'i propozojnë anëtarët për këtë komision.

z.Valon Demolli, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, përshëndetje për të gjithë, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët LDK-së, do ta bojkotojmë këtë votim për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit. Partia fituese në bashkëpunim me PDK-në dhe AAK-në i kanë numrat, dhe ashtu siç e kanë fituar pushtetin do të thotë i kanë numrat edhe për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, andaj ju uroj suksese të gjithëve, faleminderit.

(lëshohet mbledhja nga ana e Grupit të këshilltarëve të LDK-së dhe nga Grupi i këshilltarëve të AAK-së)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, theksoi, do të thotë subjekti LDK nuk ka propozim për anëtar të komisionit, atëherë e ftojme Grupin e LVV-së që të bëjë propozimin për anëtar të komisionit në fjalë.

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LVV-ja, propozojmë z.Bahri Selimin për anëtar të komisionit në fjalë.

z.Bashkim Sylja, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, fillimisht unë mendoj se kjo mbledhje nuk mund të vazhdojë sepse siç po shihet nuk ka kuorum, mirëpo edhe po të kishte kuorum qëndrimi jonë politik është se zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit pa dhënien e betimit të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, *(përkatësisht pa zëvendësimin e atyre që kanë dhënë dorëheqje)* është e pa pranueshme për ne, kështu që ne nuk kemi as kandidat për Kryesues të Kuvendit, mirëpo as nuk do ta përkrahim asnjë kandidat tjetër të ndonjë subjekti tjetër politik. Prandaj edhe ne do ta lirojmë sallën dhe nuk do të marrim pjesë në votim.

(lirohet mbledhja edhe nga ana e Grupit të këshilltarëve të PDK-së, me përjashtim të kryesuesit të mbledhjes i cili vazhdoi me kryesimin e seancës)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, theksoi, pas zhvillimeve që ndodhen duke lëshuar seancën Grupet e tri subjekteve politike, rregullat e kërkojnë që të konstatohet se a ekziston kuorumi dhe a mund të vazhdojmë mbledhjen, mirëpo paraprakisht fjalën e ka kërkuar Kryetari i Komunës, urdhëroni i nderuar Kryetari.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i respektuari Kryesues i mbledhjes, të respektuar asamblist, më lejoni që t'ju përshëndes dhe singërisht ndihem shumë keq që partia e cila faktikisht ka marrë votën për të udhëheq me Kuvendin, do të thotë qysh në start të punës rreth konsolidimit të tërësishëm të këtij Kuvendi e lëshon mbledhjen dhe në njëfarë forme e pamundëson vazhdimin e punës së këtij Kuvendi për këtë mbledhje, për arsye që ata më së miri mund t'i dinë.

Ne si subjekt politik LVV, e që vërehet këtu edhe nga prezenca jonë në sallë se nuk kemi asnjë marrëveshje me askënd, jemi subjekt që i kemi fituar zgjedhjet të vetëm dhe pa asnjë marrëveshje politike, andaj edhe do të vazhdojmë ta kryejmë punën tonë ashtu siç i kemi fituar zgjedhjet në mënyrë që të kontribuojmë në funksionalizimin e plotë të institucionit të Kuvendit të Komunës, prandaj e them se është për keqardhje që tri subjektet tjera politike në këto momente e lëshojnë sallën e Kuvendit. Unë besoj se tani opinioni publik mund ta kuptoj se kush me kënd është i koordinuar, pastaj po shihet se ne LVV si subjekt politik nuk kemi asnjë koordinim me ndonjë subjekt politik përveç me qytetarët, andaj edhe po e vazhdojmë punën për qytetarët dhe në bashkëpunim me qytetarët.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, theksoi, meqë prezent në sallë janë vetëm 14 këshilltarë dhe këshilltare të Kuvendit, e që do të duhej të ishin prezent të paktën 18 për ta bërë kuorumin dhe për të vazhduar me punë, konstatoj se punimet nuk mund të vazhdojnë për shkak të mungesës së kuorumit pasi që partitë opozitare lëshuan sallën e Kuvendit, atëherë ne nuk mund të vazhdojmë me këtë mbledhje, andaj e deklaroj të mbyllur këtë mbledhje, ndërsa për mbledhjen e ardhshme do të njoftoheni me kohë përmes zyrës përkatëse për punë të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në ora 10:20

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Osman Bajrami

Nr.01-060/04-0108876/21

Podujevë,

17 dhjetor 2021

Kryesuesi i Mbledhjes

anëtar i më i moshuar në moshë

Hilmi Hoxha _____